REPUBLIKA E SHQIPËRISË
DHOMA KOMBËTARE E NOTERISË

DEGA VENDORE TIRANË

NOTER ARDJANA A. MEDIU
ADRESA Blv.Deshmoret e Kombit,
Kullat Binjake, Kulla Nr.2, Kati i 7
TEL: 692041001

# KONTRATË SHITJE PASURI E LUAJTSHME

(KUOTA KAPITALI)

**Nr. repertori: 1676** **Nr. koleksioni: 611**

**Tirane më 25/03/2022**

Ligjet referuese:

1.Ligji nr. 7850, datë 29/07/1994 "Kodi Civil i Republikës së Shqipërisë", i ndryshuar

2.Ligji nr. 9887, date 10/03/2008 "Për mbrojtjen e të dhënave personale", i ndryshuar

3.Ligji nr. 110, datë 20/12/2018 "Për Noterinë"

A2022050620071623794

*Akti noterial përbëhet nga 2 fletë

A2022050620071623794

**KONTRATË SHITJE KUOTE KAPITALI**

Sot, më datë 25/03/2022, para meje Notere Ardjana A. Mediu, anëtare në Dhomën Kombëtare të Noterisë, Dega Vendore Tiranë, me zyrë në adresën: "Blv.Dëshmorët e Kombit", Kullat Binjake, Kulla Nr.2, Kati i 7, u paraqitën personalisht:

**Z.Urim Rexhepi,** atësia Ayni, amësia Ferdane, shtetas shqiptar, lindur në Kukës dhe banues në Tiranë, me adresë: Rr. "Jordan Misja"; Njësia Administrative Nr. 9; lindur më 04/11/1977, gjendja civile i martuar, madhor, me zotësi të plotë juridike për të vepruar, për identitetin e të cilit u garantova me Leternjoftim ID Nr. 034346123 dhe Nr. Personal H71104041G.

(këtu e më poshtë referuar si **"Shitësi"**)

**Z.Ditmir Berisha,** atësia Sulejman, amësia Hasime, shtetas shqiptar, lindur në Degë, Tropojë dhe banues në Tiranë, me adresë: Rr. "Besim Imami"; Nd. Pall I Ri; H. 1; Ap. 25; Njësia Administrative Nr. 10; 1001; lindur më 17/02/1987, gjendja civile i martuar, madhor, me zotësi të plotë juridike për të vepruar, për identitetin e të cilit u garantova me Letërnjoftim ID Nr. 035023419 dhe Nr. Personal I70217009R.

(këtu e më poshtë referuar si **"Blerësi"**)

Bazuar në nenin 73 pika 1/b të Ligjit Nr. 9901 datë 14.04.2008 "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare" – i ndryshuar dhe nenin 705 e vijues të ligjit nr. 7850 dt. 29.7.1994 "Kodi Civil i Republikës së Shqipërisë", nënshkruhet kjo kontratë për shitjen e kuotave në Shoqërinë "Vip Security" Sh.p.k, si më poshtë vijon:

**Neni 1**

**Objekti i kontratës**

1.1 Objekti i kontratës është shitja e një kuote e përbërë prej **100 % (njëqind përqind) të kapitalit themeltar**, që Shitësi, Z.Urim Rexhepi zotëron në Shoqërinë "Vip Security", tek Blerësi, Z.Ditmir Berisha, përkundrejt çmimit të përcaktuar si më poshtë.

**Neni 2**

**Çmimi i shitjes.**

2.1 Çmimi total i shitjes së kuotës që do t'i paguhet Shitësit nga Blerësi është **1 000 000 (njëmilion lekë).**

**Neni 3**

**Mënyra e pagesës**

3.1 Palët deklarojnë se çmimi i shitjes së kuotës i përcaktuar në nenin 2 të këtij kontrate, do të likujdohet brenda afatit kohor 1-javor, duke filluar ky afat me nënshkrimin e kontratës, me transfertë bankare në numrin e llogarisë të Shitësit, Z.Urim Rexhepi me IBAN AL80 2121 1401 0000 0000 0126 9560, në Bankën "Credins Bank" Sh.a.

**Neni 4**

**Detyrimet e shitësit**

4.1 Shitësi do të pranoj çmimin e shitjes, të parashikuar në Nenin 2, si çmimin e plotë dhe përfundimtar të shitjes së kuotës objekt të kësaj kontrate, që ai zotëron në Shoqërinë "Vip Security" Sh.p.k, kuotë e cila tashmë i kalon Blerësit.

A2022050620071623794

4.2 Shitësi garanton Blerësin se kuota e tij në kapital, nuk është lënë peng, në dorëzani apo rënduar me ndonjë lloj tjetër barre dhe se ai është i vetmi pronar dhe gëzon të drejta të plota mbi të.

4.3 Shitësi garanton se i ka vënë në dispozicion Blerësit të gjithë dokumentacionin financiar dhe ligjor në mënyrë që Blerësi të njihej me gjendjen financiare dhe ligjore të shoqërisë.

4.4 Shitësi mban përgjegjësi për çdo detyrim që shoqëria ka kundrejt të tretëve sipas parashikimeve të Ligjit nr. 9901 dt. 14.04.2008 "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare", i ndryshuar deri në momentin e hyrjes në fuqi të kësaj kontrate. Pas hyrjes në fuqi të kësaj kontrate, Blerësi do të përgjigjet kundrejt detyrimeve të të tretëve në përputhje me parashikimet e nenit 68 të Ligjit nr. 9901 dt. 14.04.2008 "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare", i ndryshuar.

4.5 Me nënshkrimin e kësaj kontrate, Shitësi heq dorë përfundimisht nga të drejtat që ai ka mbi kuotën objekt të kësaj kontrate.

4.6 Shitësi do të marrë të gjitha masat për të garantuar përmbushjen e të gjitha detyrimeve të marra prej tij në bazë dhe për zbatim të kësaj kontrate.

**Neni 5**
**Detyrimet e Blerësit**

5.1 Blerësi do të paguaj çmimin e blerjes, sipas mënyrës së parashikuar në nenin 3 të kësaj kontrate.

**Neni 6**
**Konfigurimi pas shitje së kuotës**

6.1 Me nënshkrimin e kësaj kontrate dhe regjistrimit të saj në Qendrën Kombëtare të Regjistrimit të Bizneseve konfigurimi i kuotës në kapitalin themeltar të Shoqërisë "Vip Security" Sh.p.k do të jetë:

- Z.Ditmir Berisha, Ortak i Vetëm me 100 % të kuotës.

**Neni 7**
**Gjuha e Kontratës dhe hyrja në fuqi**

7.1 Kjo kontratë përgatitet në 3 kopje në gjuhën shqipe, të gjitha të njëvlershme dhe origjinale.
7.2 Secila prej palëve në këtë kontratë do të marrë një kopje të kontratës.
7.3 Kjo kontratë hyn në fuqi me nënshkrimin e saj prej palëve.

**PALËT KONTRAKTUESE**

| | |
|---|---|
| **SHITËSI** | **BLERËSI** |
| Z. Urim Rexhepi | Z.Ditmir Berisha |
| Urim Rexhepi | Ditmir Berisha |

**NOTERE**
**Ardjana A. Mediu**

**Shoqëria Tregtare "Vip Security" Sh.P.K**
**NIPT Nr.L72021028V**
**"Rruga e Dibrës", Kompleksi Halili, Pallati D, Kati 1**

**VENDIM**

**Nr. 1, datë 25/03/2022**

**I Ortakut Të Vetëm Të Shoqërisë "Vip Security" SH.P.K**

Sot më datë 25/03/2022, në Tiranë, në selinë e Shoqërisë "Vip Security" Sh.p.k., person juridik, me Nipt-L72021028V, me seli në Tiranë, Rr. "e Dibrës", "Kompleksi Halili", Pallati D, kati 1, u mblodh Asambleja e Shoqërisë "Vip Security" me Ortakut të Vetëm:

**Z.Urim Rexhepi,** atësia Avni, amësia Ferdane, shtetas shqiptar, lindur në Kukës dhe banues në Tiranë, me adresë: Rr. "Jordan Misja"; Njësia Administrative Nr. 9; lindur më 04/11/1977, gjendja civile I martuar, madhor, me zotësi të plotë juridike për të vepruar, mbajtës i Letërnjoftimit ID Nr. 034346123 dhe Nr. Personal H71104041G, për shqyrtim rendin e ditës si më poshtë vijon:

1- Shitje e kuotës në masën 100 % tek Bleresi Z.Ditmir Berisha, atësia Sulejman, amësia Hasime, shtetas shqiptar, lindur në Degë, Tropojë dhe banues në Tiranë, me adresë: Rr. "Besim Imami"; Nd. Pall I Ri; H. 1; Ap. 25; Njësia Administrative Nr. 10; 1001; lindur më 17/02/1987, madhor, me zotësi të plotë juridike për të vepruar, me Letërnjoftim ID Nr. 035023419 dhe Nr. Personal I70217009R.

2- Emërimin në postin e Administratorit të Ri të Shoqërisë "Vip Security" të Z.Ditmir Berisha.

Në përfundim, Ortaku i vetëm

**VENDOSI:**

1. Shitjen e kuotës në masën 100 % tek Bleresi Z. Ditmir Berisha.
2. Emërimin në postin e Administratorit të Ri të Shoqërisë "Vip Security" të Z.Ditmir Berisha.

**Ortak I Vetëm Dhe Administrator i Shoqërisë "Vip Security" Sh.p.k.**

**Z. Urim Rexhepi**

Urim Rexhepi

VIP SH.P.K. SECURITY

REPUBLIKA E SHQIPËRISË

MINISTRIA E FINANCAVE DHE EKONOMISË

QENDRA KOMBËTARE E BIZNESIT

# CERTIFIKATË REGJISTRIMI

**NUMRI SERIAL:**
**SN-537462-05-18**

Personit të tatueshëm:

VIP SECURITY

Statusi

Aktiv

Me adresë kryesore

Tirane, Tirane, TIRANE, Njesia Bashkiake nr.8, rruga e Dibres, Kompleksi Halili, Pallati D, kati 1

I jepet ky numër identifikimi (NUIS)

L72021028V

Afati i veprimtarisë

Nga : 16/08/2017 deri

**DATA E REGJISTRIMIT**

21/08/2017

**DATA E LËSHIMIT**

24/03/2022

**QENDRA KOMBËTARE E BIZNESIT**

**SPORTELI I SHËRBIMIT:**

Kjo çertifikatë është rreptësisht e ndaluar të plastifikohet

**(Emri, Mbiemri) i nëpunësit të sportelit**

Vulosur elektronikisht nga Qendra Kombëtare e Biznesit
Date:2022/03/24 09:11:53 +02'00'
L72021028V20220324091138111006

*Shënim : Ky dokument është gjeneruar dhe vulosur me anë të një procedure automatike nga një sistem elektronik (Qendra Kombëtare e Biznesit)*

"Selvia", Kati V
TIRANE, SHQIPERI
TEL/FAX :355 4 2420005
TEL:355 4 2420006
Email: rbs@roen-al com

# Regjistri i Barrëve Siguruese

## REZULTATET E KËRKIMIT

| | |
|---|---|
| Numri i Rezultatit te Kerkimit: | D-20220324121510528 |
| Data e Rezultatit te Kerkimit: | 24.03.2022 |
| Ora e Rezultatit te Kerkimit: | 12:15:10PM |
| Lloji i Kerkimit: | |
| Numri i Dokumentit: | D-400-005-764 |
| Referenca e Perdoruesit: | |

**LISTA E PERSONAVE ME REZULTAT KERKIMI 0**

VIP SECURITY SH.P.K.

REGJISTRI I BARREVE SIGURUESE R.B.S. TIRANË - ALBANIA

Rudina [signature]